VENDIM
Nr. 22/2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 90/2017 "PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 21, pika 2, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

I. Deputeti Damian Gjiknuri caktohet anëtar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Deputeti Arben Pëllumbi largohet nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat dhe caktohet anëtar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

III. Deputetja Mirela Kumbaro caktohet anëtare në Komisionin për Integrimin Europian dhe në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

IV. Deputetët Senida Mesi dhe Vullnet Sinaj caktohen anëtarë në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

V. Deputetët Alket Hyseni, Ditmir Bushati dhe Reme Lala caktohen anëtarë në Komisionin për Politikën e Jashtme.

VI. Deputetja Lindita Nikolla caktohet anëtare në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe deputeti Fatmir Velaj largohet nga ky komision.

VII. Deputetet Antoneta Dhima dhe Elena Xhina caktohen anëtare në Komisionin për Sigurinë Kombëtare dhe deputeti Vullnet Sinaj largohet nga ky komision.

VIII. Deputetja Klotilda Bushka largohet nga Komisioni për Politikën e Jashtme dhe caktohet anëtare në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 21.1.2019.